



Roli i Organizatave Rajonale në promovimin e rregullave aktuale për përshejtimin e tranzicionit të energjisë duke patur në fokus rritjen e sigurisë së furnizimit.

30 Nëntor 2022, Cairo, Egjipt

MEDREG, Shoqata e Rregullatorëve të Rajonit për Energjinë, organizoi me sukses një workshop të nivelit të lartë dhe një dialog të zgjeruar strategjik mbi "Rolin e Organizatave Rajonale në promovimin e rregullave aktuale për përshejtimin e tranzicionit të energjisë duke patur në fokus rritjen e sigurisë së furnizimit", me mikëpritje të GasReg, Autoriteti Rregullator i Gazit në Egjipt.

Objektivi i këtij eventini ishte ndër të tjera të vëre në fokus "principet më të mira rregullatore" të cilat duhet të karakterizojnë misionin, punën dhe kompetencën e Autoriteteve Rregullatore Kombëtare me qëllim rrugëtimin drejt dekarbonizimit në tregjet e energjisë.

Rregullatorët kanë një rol tejet të rëndësishëm në tranzicionin e energjisë.

Për më tepër, seminari synoi të diskutojë ndër të tjera dhe alternativa apo skenare për një treg energjie Mesdhetar të integruar dhe në ndërveprim, me fokus për të theksuar dhe rritur rolet e enteve rajonale dhe organizatave, drejt një tregu të qëndrueshëm dhe kompatibël të energjisë.

Në këtë seminar të Presidentëve të Rregullatorëve të Medreg janë ftuar dhe ishin pjesmarrës disa ekspertë të nivelit të lartë menaxherial në organizata rajonale dhe Europiane në fushën e energjisë si:

- CEER – Këshilli i Rregullatorëve European të Energjisë
- ECRB – Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë
- OME – Observatori Mesdhetar i Energjisë

- MedOST- Operatorët e Sistemit të Transmetimit Mesdhetar
- RCREEE- Qendra Rajonale për Energjinë e Rinovueshme dhe Efiçencën e Energjisë
- UFM – Unioni për Mesdheun
- ERRA – Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë
- EMGF – Forumi i Gazit Mesdhetar Lindor
- RegulaE.Fr – Rrjeti Frengjishtfolës i Rregullatorëve të Energjisë
- Industria e Gazit në Egjipt

Gjatë fjalës së tij Presidenti i MEDREG, njëkohësisht Kryetar i ERE-s, z. Petrit Ahmeti, foli mbi rëndësinë e rajonit të Mesdheut jo vetëm për nga madhësia, që do të ndikonte në tregun global të energjisë; por dhe si vendndodhje e disa rezervave të konsiderueshme të gazit natyror, të cilat mund të përdoren si burime energjie për të zbutur tranzicionin energjitik. Edhe pse zhvillimi i një strategjie energjitike për një rajon si mesdheu, ku çdo vend ka karakteristikat dhe të veçantat e tij, është sfiduese, sipas Presidentit Ahmeti, rregullatorët luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në lehtësimin e këtij procesi. Duke qënë ura lidhëse mes konsumatorëve apo investitorëve privatë dhe ligjvënësve, rregullatori ka potencialin të këshillojë këta të fundit, duke u përcjellë këndvështrimin e të gjitha palëve të interesit. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e një kuadri rregullator të përbashkët, në qëndrueshmërinë e tregut rajonal të energjisë duke u bërë kështu më tërheqës dhe për investitorët e energjisë së gjelbër. MEDREG, nuk ka për qëllim vetëm krijimin e një mjedisi bashkëpunues dhe të një kuadri rregullator të harmonizuar, por nëpërmjet mbështetjes për reformat kombëtare, shoqata synon të shërbejë dhe si një platformë dialogu dhe bashkëpunimi midis vendeve mesdhetare.